



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike

Mbledhja nr. 14

Prishtinë, më 15 qershor 2010, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJE TË FINANCAVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Haki Shatri, Safete Hadergjonaj, Kosara Nikoliq, Gani Koci, Synavere Rysha, Naser Osmani, Riza Smaka dhe Enis Kervan.

Mungoi: Anita Morina – Saraçi.

Të ftuar: Lars Lage – OLOFSSON - auditor gjeneral, RTK - Rrahman Paçarizi - kryetar i Bordit të RTK-së, Trusti i Kursimeve Pensionale - Ymer Havolli, kryesues i Bordit (u.d), Adrian Zalli - drejtor menaxhues dhe Vërshim Hatipi - zëvendës drejtor.

Të pranishëm: Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit, Fatime Qorri – zyrtare ligjore, Musa Rudaku – zyrtar i fushës për ekonomi dhe financa, nga KIPRED (staf mbështetës) - Artan Venhari dhe Albert Krasniqi, Shpresa Miftari – praktikante, Qëndresa Mulaj – ZAP, Zyra e Presidentit – Nexhat Shatri, OSBE- Lejla Selimi, KDI – Jusuf Zejna.

Mbledhjen e kryesoi Haki Shatri, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite

1. **Miratimi i rendit të ditës,**
2. **Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të 11. 05. 2010 dhe 01. 06. 2010,**
3. **Shqyrtimi i pasqyrave të audituara të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2009,**
4. **Shqyrtimi i pasqyrave financiare dhe i Raportit të auditorëve të pavarur të RTK-së për vitin 2009.**
5. **Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e miratoi rendin e ditës pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të 11. 05. 2010 dhe 01. 06. 2010

Synavere Rysha – Në diskutimin e saj, në procesverbalin e datës 01 qershor 2010, te fjalja: “...NJQH-ja është institucioni i vetëm...” ka thënë: “...NJQH-ja është ndër institucionet e vetme...”.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e miratoi procesverbalin e datës 11 maj 2010, pa vërejtje dhe procesverbalin e datës 01 qershor 2010, me vërejtjen e deputetes Synavere Rysha.

3. Shqyrtimi i pasqyrave të audituara të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2009

Kryesuesi – I ftoi përfaqësuesit e Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës ta paraqitnin Raportin.

Ymer Havolli - kryesues i Bordit (u.d) – E paraqiti në pika të shkurtra Raportin e Trustit të Kursimeve Pensionale. Trusti i ka ulur tarifën menaxhuese nga 0.9% në 0.8%. Nga kjo tarifë menaxhuese - 60% e mjeteve shkojnë në mbulimin e kërkesave ose të pagesave, të cilat shkojnë për “aset menaxher”, që disponojnë me mjetet e Trustit dhe e bëjnë investimin e mjeteve. Pjesa tjetër është e orientuar në aktivitetet operacionale të Trustit. Në vitin 2010 kanë ndërmarrë hapa konkretë për miratimin e strategjisë për vitin 2010. Kjo strategji parasheh që 40% e mjeteve të investohen në aksione, 30% e mjeteve në kthimin absolut, 30% në tregun e parave dhe depozitave bankare. Në Kosovë janë investuar rreth 25 milionë euro në sistemin bankar, mirëpo bankat me kushtet, të cilat i ka kërkuar Trusti, nuk kanë pranuar. Në prill është dorëzuar raporti i auditorit të pavarur në përputhje me ligjin, sipas të cilit Trusti është i detyruar ta bëjë këtë, deri në fund të muajit prill.

Adrian Zalli - drejtor menaxher – Trusti e ka pasur performancën më të mirë të fondeve në vendet e rajonit. Ai nuk ka taksë hyrëse dhe dalëse, por e ka vetëm taksën menaxhuese, të cilën do të vazhdojë ta zvogëlojë edhe në vitet e ardhshme.

Vërshim Hatipi – Çështje me rëndësi është fakti se disa prej mjeteve vazhdojnë të mos jenë të alokuara në konto individuale. Në këtë drejtim është bërë një përmirësim i dukshëm. Në vitin 2008 ka qenë 8.8%, në vitin 2009 ka zbritur në 4.9%. Sa u përket aseteve pensionale - viti 2009, është përmbyllur me 380 milionë euro, kontribute të reja 85 milionë. Po ashtu kthimi në investim ka bërë që mjetet në menaxhim të rriten. Shpenzimet e përgjithshme 1.8 gati 1.9. 54% kanë shkuar për t'i paguar shpenzimet e investimeve, shpenzime nëpërmjet menaxhuesve të mjeteve si dhe transferet ndërkombëtare. Kostot e stafit në përgjithësi janë 21%, mirëpo 18.5% janë pagat, ndërsa 2.5% janë trajnime, kontribute pensionale që paguan punëdhënësi, puna pas orarit, kontributet e anëtarëve të Bordit janë një shpenzim 4%. Në vazhdimësi shihet një rritje e kontributeve të arkëtuara. 1.3 milionë janë bërë refundime gabimisht, ndërsa 3 milionë janë paguar në formë të pensionit.

Synavere Rysha – Kërkoi sqarim për tarifën menaxhuese, sepse në raportin e auditorit tarifa menaxhuese është 0.9%, ndërsa në raportin e Trustit tarifa menaxhuese është 0.8%. Në muajin maj ka qenë njëra ndër ato e cila ka kërkuar që tarifa menaxhuese të zbritet në 0.6%, por nuk është përkrahur nga Kuvendi. Çështje shqetësuese është se mjetet janë kryesisht në bankat jashtë vendit, të cilat kanë një performancë jo të mirë. Gjatë periudhës së krizës botërore ka rënë vlera e aksioneve dhe Trusti ka pasur humbje të mëdha. Performancë pozitive do të ishte sikur të rritej vlera e aksionit. Pyeti: Sa është rritur ajo performancë - nga rënia e vlerës së aksioneve - në situatën aktuale, sepse ende nuk është arritur nivelizimi?

Pati vërejtje se raporti nuk ishte i nënshkruar. Etika e auditorit nuk lejon të procedohet një raport i panënshkruar dhe i pavulusur.

Riza Smaka – Pati vërejtje në raportin e Trustit. Në faqen 1 të këtij raporti thuhet “...administrimi i këtyre llogarive individuale është përgjegjësi ligjore e Trustit, përderisa paratë mbesin pronë vetjake e kontribuuesit, edhe pse pronë private mandati i këtyre kursimeve është specifik, ato mund të përdoren vetëm për pension....”. Sipas tij kjo është kolizive, sepse prona private është e pacenueshme. Nëse mjetet janë të kontribuuesit, ato nuk do të mund të kufizoheshin qoftë për destinacion, qoftë për konditat e përdorimit. Kostoja e stafit, sipas raportit, është 399 mijë euro, 21 të punësuar, paga mesatare 1400 euro për një nëpunës. Kjo shumë është padrejtësisht e lartë, krahasuar me nëpunësit civilë, që kryejnë punë madje edhe më të ndërlikuara. Ç’është sigurimi fiduciar i borxhit? Në realitet nuk ka sigurim shëndetësor, invalidor etj. Nuk është në rregull që Trusti dhe disa kompani të kenë sigurim me para të të vobektit dhe të të nëpërkëmburit. Pyeti: Sa është paga e drejtorit të Trustit?

Gani Koci – Tha se në fund të vitit 2008 - për vitin 2009, Kuvendi nuk e ka miratuar kërkesën e Trustit, që të ulej taksa menaxhuese nga 0.9% në 0.8%. Për vitin 2010, Kuvendi e ka miratuar këtë kërkesë. E metë e këtij raporti është se nuk e ka emblemën e kompanisë audituese dhe nuk përmban asnjë rekomandim për përmirësimin e performancës. Sa i përket çështjes së pagave, me ligj janë të përcaktuara sa do t’i kenë pagat institucionet financiare, të cilat nuk duhet ngatërruar me institucionet e shërbyesve civilë. Nëse dikush konsideron se ka pengesa të kësaj natyre, duhet ndryshuar ligjin. Gjendja aktuale e pagave të këtij institucioni është në kuadër të ligjit.

Safete Hadergjonaj – Tha se në përgjithësi vërehet një performancë pozitive. Kostoja e stafit ka një ulje për 37 mijë e 671 euro. Te pjesa a Bordit ka një rritje, por Bordi sigurisht nuk ka funksionuar gjatë vitit 2008. U pajtua me mendimin se raporti është dashur të ketë rekomandime në mënyrë që të krijohet një opinion real. Duhet t’i besohet raportit të auditorit, sepse ne mund të kemi informatë si po menaxhohen mjetet publike. Tek pasqyrat financiare dhe te korrespondenca vërehet një rritje e mjeteve në krahasim me vitin 2008. Për çka shkojnë këto mjete? Paga në institucione financiare duhet të dallojë nga pagat në institucionet e tjera. Duhet të merret parasysh gjendja në Kosovë, në mënyrë që këto paga të mos jenë astronomike në raport me të tjerët. Për hir të opinionit nuk është keq që pagat të bëhen publike.

Naser Osmani – Pyeti kryesuesin: Apo shqyrtohet në Komision raporti i auditorit apo raporti i Trustit të Kursimeve Pensionale? Raporti i auditorit, i cili është temë shqyrtimi, duhet të jetë i nënshkruar. Nga materiali që ai ka në disponim nuk mund të flitet për një raport të audituar. Po ashtu pati vërejtje se nuk është temë diskutimi paga. Paga është vetëm një segment në gjithë këtë raportim.

Kryesuesi – I njoftoi anëtarët e Komisionit se raporti është shpërndarë në bazë të përfundimit të Kryesisë së Kuvendit. Pra, zyrtarisht, Komisioni e ka marrë këtë dokument si raport të audituar. Në versionin anglisht raporti e ka logon e kompanisë audituese. Propozoj që raporti të përkrahet, sepse është i plotë. Ajo çka duhet të diskutohet është se janë 3 milionë euro, që kanë mbetur të pashpenzuara nga vitet e kaluara. Kur kësaj i shtohet taksa aktuale menaxhuese 0.8%, duket se sikur do të këtë tepër mjete. Prandaj, ndoshta në vendimin e radhës, duhet të kihet parasysh bilanci dhe taksa menaxhuese që Trusti e ka në disponim. Të ardhurat janë pjesë e shpenzimit të parësë publike dhe rekomandimi për të nisur procedurë lidhur me këtë çështje nuk mund të mohohet.

Ymer Havolli - kryesues i Bordit (u.d) – U përgjigj se me Bordin e ri është bërë ulja e tarifës menaxhuese. Sa i përket kostonë së stafit, Trusti është duke punuar sipas ligjit në fuqi. Duhet të merret parasysh fakti se po diskutohet për tre zyrtarë dhe për tri funksione specifike – ekspertë me përvojë në funksionimin e bursave dhe fondacioneve pensionale.

Adrian Zalli - drejtor menaxher - Tha se auditimin e ka bërë kompania audituese e cila është ndër tre auditorët e aprovuar nga Banka Qendrore, për auditimin e institucioneve financiare. Kërkesë e kompanisë audituese ka qenë që logoja të jetë vetëm në versionin në gjuhën angleze, në bazë të kontratës së nënshkruar para shpalljes së pavarësisë së Kosovës, kur edhe raportet e audituara janë bërë vetëm në gjuhën angleze.

Vërshim Hatipi – Ne do të dërgojmë dëshminë për raportin e audituar. Lidhur me “sigurimin fiduciar”, ai theksoi se një anëtarë i Bordit duhet të ketë një sigurim fiduciar kundrejt veprimeve që i ndërmerr ndaj aseteve të atij institucioni. Si i tillë kjo e mbron kontribuesin dhe anëtarin. Bankat në Kosovë kanë likuiditet më se 500 milionë. Këto banka kanë ardhur me disa kamata shumë të vogla, ndërsa disa të tjera nuk kanë shprehur interes fare, pastaj është edhe kufizimi ligjor 5%.

Kryesuesi konstaton se KMFP-ja, pasi që Trusti i Kursimeve Pensionale i Kosovës ta procedojë në Kuvend dëshminë në gjuhën shqipe se është fjala për një raport të audituar, Kuvendit do t'i

REKOMANDOJË

1. *Të miratohen pasqyrat e audituara vjetore për vitin 2009 të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës.*
2. *Para se të vendoset për normën tjetër të menaxhimit - kurdo që të ndodhë kjo - të diskutohet për strukturën e shpenzimeve, përfshirë edhe pagën dhe të merret vendim përkatës në komisionet përkatëse.*

4. Shqyrtimi i pasqyrave financiare si dhe i Raportit të auditorëve të pavarur të RTK-së për vitin 2009

Kryetari – Tha se sipas vendimit të seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës deri më 15 mars 2010, në Kuvend duhet të dorëzohet Raporti i audituar i pasqyrave financiare dhe i performancës së auditorit të jashtëm të pavarur të RTK-së. Fjalën ia dha kryetarit të Bordit të RTK-së.

Rahman Paçarizi – kryetar i Bordit të RTK-së – Tha se kompania audituese, e cila e ka bërë auditimin e pasqyrave financiare të RTK-së, ka konstatuar se pasqyrat financiare janë paraqitur në mënyrë të drejtë. Meqenëse Bordi aktual i RTK-së është konstituar në fund të tetorit të vitit të kaluar dhe për vitin që është audituar, qoftë në aspektin e pasqyrave financiare, qoftë në çështje të performancës, ose të zbatimit të rekomandimeve nga viti 2008 për vitin 2009, ka përgjegjësi dymujore.

Sylejman Shaqiri – Drejtor i RTK-së – Tha se në Raportin vjetor, në fjalën hyrëse të drejtorit të përgjithshëm, e kemi tërhequr vëmendjen e lexuesve që hartuesit e raporteve nëpër njësi të ndryshme është dashur të shkruajnë raport për një segment, për një veprimtari, të cilën ata nuk e kanë udhëhequr gjatë vitit 2009.

Gani Koci – Tha se Raporti nuk e përmbush vendimin që është marrë në Kuvend. Sipas pikës tre të vendimit të seancës plenare të Kuvendit të Kosovës, “Kuvendit duhet t'i dorëzohet raporti i auditorit të pavarur për pasqyrat financiare dhe të performancës së RTK-së, për vitin 2009, deri më 15 mars 2010”. Ne e kemi marrë vetëm raportin për pasqyrat financiare të auditorëve të pavarur të RTK-së. Deri më tash jemi ballafaquar shumë herë me të njëjtin auditor “Audit@Conto”. Pyeti: A ka RTK-ja marrëveshje apo kontratë afatgjatë me këtë auditor? Sepse, raportet nga viti në vit dallojnë vetëm në disa shifra, ndërsa përshkrimi është i njëjtë. Kjo e bën të dyshimtë mënyrën e auditimit të RTK-së. Ka një dallim shumë të madh në mbikëqyrjen e RTK-së, që është bërë nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), lidhur me të hyrat që kanë ardhur nga reklamat. Sipas raportit të zyrës së mbikëqyrjes, KPM-ja, sipas minutave dhe sekondave që janë transmetuar për reklamë, sipas çmimoreve të RTK-së, vërehet një dallim shumë i madh, në krahasim me atë që është paraqitur në pasqyrat financiare për të hyrat nga reklamat. Këtë shpërputhje kaq të madhe nuk e ka thënë auditori i pavarur. Dhe në momentin kur ishte përpiluar raporti i performancës, kishin dalë këto defekte që u potencuan. Kërkoj që të përmbushet edhe pika e tretë e vendimit të Kuvendit dhe raporti të procedohet i plotësuar.

Rrahman Paçarizi – Duke u përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të Komisionit, tha se përgjegjësinë për pasqyrat financiare të audituara, e bart kompania audituese. Lidhur me raportin e mbikëqyrjes nga KPM-ja, shqetësimet janë të drejta. Kërkoj ndihmë për ta gjetur mënyrën për të barazuar raportin e mbikëqyrjes të KPM-së dhe të të dhënave të RTK-së, për vitin 2009.

Kryesuesi – Këtu në material, në faqen 5, shihet bilanci i gjendjes. Me nënshkrimet tuaja keni pranuar se ato pasqyra janë produkti juaj. Auditori i përgjithshëm, pas 15 shkurtit deri 15 mars, ka konstatuar se pasqyrat që ju i keni konstatuar si autentike, tuajat, janë në rregull. Me këtë nënkuptohet që ju e merrni përgjegjësinë.

Sylejman Shaqiri – E pranon përgjegjësinë për numrat që janë mbledhur, zbritur dhe janë shumëzuar mirë, por nuk merr përgjegjësinë për atë se çfarë ka ndodhur gjatë vitit. Asnjëherë nuk e ka parë raportin e mbikëqyrjes së KMP-së, megjithëse e ka kërkuar. Pozita e tij është thjeshtë pozitive ligjore. Procedurat përzgjedhjen e auditorit kanë qenë shumë transparente dhe në kuadër të ligjit.

Synavere Rysha – Mbetet prapa asaj se raportet e auditorit duhet të jenë të nënshkruara, të dihet autorësia. Këtu duhet të ketë përgjegjësi individuale dhe secili duhet të përgjigjet për punën e vet, për etikën e vet. Ajo tha se i ftuar në këtë takim do të duhej të ishte edhe auditori që ka bërë auditimin e pasqyrave financiare të RTK-së. Ky Raport është i mirë, edhe pse i mangët. Paraqet një politikë keqmenaxhuese, jo të drejtë dhe jo korrekte sa i përket RTK-së. Raporti që e ka bërë auditori është në bazë të asaj se çfarë i ka ofruar menaxhmenti. Në faqen e parë thuhet “*pasqyrat financiare të kompanisë që përfundon me 31 Dhjetor 2008*”, që është bazuar dhe është dashur të bazohet, janë audituar nga ZAP-i, në të cilin raport nuk janë paraqitur pasqyrat financiare për të cilat jepet opinioni. Nëse nuk përputhet me raportin e KPM-së, përgjigjja duhet të kërkohej dikund tjetër, duhet të kërkohej çfarë ka ndodhur brenda RTK-së. Ky institucion ka komoditet që asnjëra nga institucionet shtetërore nuk i kanë dhe përsëri kërkojnë mjete nga buxheti i Kosovës.

Safete Hadergjonaj – Tha se auditori pasi të fillojë të auditorë ka të drejtë të kërkojë çdo njoftim, kurse menaxhmenti duhet t’i përgjigjet. Në rast se menaxhmenti nuk i është përgjigjur kërkesave të auditorit, auditori do ta kishte theksuar në Raport se mungojnë njoftimet etj. Raportet e auditorëve të pavarur, që janë proceduar në Kuvend deri më tani, janë të njëjta. Asnjëra nuk përmban rekomandime. Ndoshta Komisioni duhet ta japë një vërejtje publike për auditorët që t’i plotësojnë standardet e raportimit. Me vendim Kuvendi e ka kërkuar raportin e performancës, që dallon nga raporti i pasqyrave financiare. *Pse nuk e kemi një raport të performancës? Çfarë ka bërë menaxhmenti që ne ta kemi këtë raport, që e tregon arsyeshmërinë e këtyre mjeteve dhe jo vetëm rregullativën e këtyre mjeteve?* - mund të na japin përgjigje të ftuarit, pastaj Komisioni do të kishte mundësi t’i krahasonte të gjeturat e auditorit me të gjeturat e KPM-së.

Kryesuesi konstatoi se KMFP-ja njëzëri ka vendosur që Kuvendit t’ia rekomandoj miratimin e Raportit të auditorëve të pavarur të RTK-së për pasqyrat financiare për vitin 2009, mirëpo për shkak të mospërmbljes së vendimit të seancës plenare nr. 03-V-237, të 28 janarit 2010, ka vendosur që Kryesisë së Kuvendit t’i

REKOMANDOJË

1. Shqyrtimi në seancë plenare i Raportit të auditorëve të pavarur të RTK-së për pasqyrat financiare për vitin 2009, të bëhet pasi në Kuvendin e Kosovës të procedohet edhe raporti i audituar i performancës së RTK-së për vitin 2009.

4. Të ndryshme

Kryesuesi i njoftoi anëtarët e Komisionit se mbledhja e radhës e Komisionit do të mbahet ditën e premte, më 18 qershor 2010. Në këtë mbledhje do të propozohet ky rend dite: *Shqyrtimi i*

pasqyrave financiare dhe i Raportit të Auditorit të Pavarur – Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit dhe Prezantimi i përmbushjes së sfidave të dala nga Raporti i Progresit për: Komisionin Rregullativ për Prokurimin Publik, Organin Shqyrtues të Prokurimit, Agjencinë Publike të Prokurimit dhe Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm.

Safete Hadergjonaj – Propozoi që në mbledhjet e KMFP-së të angazhohet një person kompetent nga ZAP-i – auditor i certifikuar. Ai person mund t'i ndihmojë Komisionit me njoftime dhe ta luajë rolin kyç në Komision. Kjo është praktikë e të gjitha vendeve që kanë një KMFP.

Mbledhja përfundoi në orën 13:22

E përqatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Haki Shatri